

MARINA RESIDENCES VLORË
TIRANE FARKE LUNDER LOBBY HOME, RRUGA NACIONALE
TIRANE- ELBASAN, PERBALLE QENDRES TREGTARE TEG
M12103049U

Sot, më datë 15.06.2022 , në selinë e Shoqërisë “**Marina Residences Vlorë**” sh.p.k. me NUIS M12103049U (më tej referuar si “Shoqëria”), në adresën “Tirane Farke Lunder Lobby Home, Rruga Nationale Tirane- Elbasan, Perballe Qendres Tregtare TEG” u paraqitën palët e mëposhtme ortake të Shoqërisë:

- “**Marina Di Valona**” sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS M01324008A me seli në adresën: “Tirane Farke Lunder Lobby Home, Rruga Nationale Tirane- Elbasan, Perballe Qendres Tregtare TEG” , përfaqësuar nga administratori Eranda Muskaj - ortak i Shoqërisë dhe zotërues e 80% (tetëdhjetë përqind) e kuotave të kapitalit themeltar të saj
- “**Brunes**” sh.p.k. një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qëndres Kombëtare të Biznesit me NUIS K37125203H me seli në adresën: “Kashar KASHAR Autostrada Tirane Dures, Km7, ZK 2105, Ndertesa me Nr Psurie 187/23 dhe Nr Pasurie 187/24,” , përfaqësuar nga administratori Geront Çela - ortak i Shoqërisë dhe zotërues e 20% (njëzet përqind) e kuotave të kapitalit themeltar të saj

Znj Eranda Muskaj si përfaqësues ligjor i Ortakut mazhoritar, merr drejtimin e mbledhjes në cilësinë e Kryetarit dhe deklaron vullnetin e ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

Rendi i Ditës

- I. **Zmadhimi i Kapitalit te Shoqerise ne vlere prej 3.025.597 LEK (tre milionë e njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) nepermjet emetimit te nje kuote te re te kapitalit shoqeroror te barsvlereshme me vleren e zmadhimit dhe qe i korrespondon pjesmarrjes prej 10% ne Kapitalin Shoqeror;**
- II. **Miratimi i shlyerjes se kuotes se re te ematuar nga Shoqeria e barsvlereshem me 10% te Kapitalit Themletar nga ortaku i ri Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group sh.p.k e cila duke injektuar këtë kapital në Shoqëri, përfiton një kuotë në kapitalin e kësaj të fundit.**
- III. **Miratimi i përqindjeve respektive të ndryshuara për secilin ortak pas miratimit të kapitalit shtesë të rritur të injektuar nga Balfin - Balkan Finance Investment Group si më poshtë nga secili ortak.**

Në lidhje me pikat në Rend të Ditës, Kryetari parashton se kapitali i shoqërisë është 27 230 375 Lekë (njëzet e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë lekë), përkatësisht Marina di Valona sh.p.k ka kontribuar kapital shumë më 21.784.300 Lekë (njëzet e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind) e barsvlereshme me 80 % (tetëdhjetë përqind) dhe Brunesh.p.k ka kontribuar në kapital 5.446.075 lekë (pesë milion mijë e katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë pesë lekë) e barsvlereshme me 20 % (njëzet përqind).

Në kuadrin e zhvillimit të projekteve të reja Ortakët dëshirojnë të afrojnë ne Shoqëri investitor te interesuar dhe per rrjedhim ofrojnë një kuote pjesëmarrje ne shoqëri te barasvlershme me 10% te pjesëmarrjes ne kapitalin shoqëror kundrejt shlyerjes se zmadhimit te kapitalit ne shumen prej 3.025.597 LEK (tre milionë e njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë).

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k, shoqëri me historik në fushën e investimeve strategjike ka shprehur interes të angazhohet si ortak në projektet e reja të shoqërisë, të paguajë zmadhimin e kapitalit duke shlyer zmadhimin e kapitalit prej 3.025.597 LEK (tre milionë e njëzet e pesë milionë e pesëqind e e nëntëdhjetë e shtatë mijë lekë) më qëllim përfitimin e një kuotë të barabartë me 10 % (dhjetë përqind) te Kapitalit Shoqëror ne Shoqërinë "Marina Residences Vlorë" sh.p.k.

Si rezultat i sa me sipër vlere e pjesëmarrjes se kuotat ne pronësi te ortakeve ekzistues, pavarësisht se nuk ndryshojen ne shumen e disponuar ne para do te *zbehet* proporcionalisht me pjesëmarrjen e tyre.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë me vlerën totale 3.025.597 LEK(tre milionë e njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) nepermjet emetimit te nje kuote te re te kapitalit shoqeror te barsvlereshme me vleren e zmadhimit dhe qe i korrespondon pjesmarrjes prej 10% ne Kapitalin Shoqeror.**
- B. Miratimi i shlyerjes nga ana e shoqërisë Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia bashkiake nr.2, Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K te kuotes se ematuar me vlere nominale 3.025.597 LEK(tre milionë e njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) qe i korrespondon pjesmarrjes prej 10% ne Kapitalin Shoqeror;**
- C. Kapitali i ri i Shoqërisë do të jetë në vlerën totale prej 30.255.972 LEK (tridhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy lekë) i ndare ndërmjet orakeve si ne vijim:**
 - **Marina di Valona sh.p.k në vlerën 21.784.300 LEK (njëzet e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind lekë qe i korrespondon pjesmarrjes prej 72% te Kapitalit shoqeror;**
 - **Brunes sh.p.k në vlerën 5.446.075 LEK (pesë milionë e katërqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e pesë lekë) qe i korrespondon pjesmarrjes prej 18%;**
 - **Balfin - Balkan Finance Investment Group sh.p.k në vlerën 3.025.597 LEK (tre milionë e njëzet e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) qe i korrespondon pjesmarrjes prej 10%;**
- D. Të autorizojë administratorin që në emër dhe për llogari të Shoqërisë të kryejë gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi në Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.**

* * * * *


Meqenëse nuk kishte çështje të tjera për tu shqyrtuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur. Ky Vendim i Shoqërisë, i mbajtur në formën e procesverbalit, nënshkruhet rregullisht në përputhje me parashikimet e nenit 90/3 të Ligjit nr. 9901., datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nga Sekretari dhe Kryetari i Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE E SHOQËRISË
"Marina Residences Vlorë" sh.p.k

SHOQËRIA E KRYEQARËVE TË SHOQËRISË
"Marina Residences Vlorë" sh.p.k

KRYETARI

Marina Di Valona sh.p.k


Eranda Muska
Përfaqësues Ligjor i shoqërisë

ORTAK I SHOQËRISË

Brunes sh.p.k


Geront Cela
Përfaqësues Ligjor i Shoqërisë

